




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024**



Prishtinë, 2024

BULETINI

i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Prishtinë, maj 2024



Këshilli Prokurorial i Kosovës merr pjesë në mbledhjen e Këshillit Ministror për Integrim Evropian

Prishtinë, 2 maj 2024

Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, ka marrë pjesë në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian, në të cilin ishte në rendin e ditës diskutimi për Planin e reformave në kuadër të Planit të ri të BE-së për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor dhe reformat e Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028.

Në këtë mbledhje, Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli, raportoi për aktivitetet e Këshillit Prokurorial, duke potencuar angazhimin e shtuar për përmbushjen e 11 masave, në mesin e të cilave 4 janë të natyrës legislative dhe 7 të natyrës zbatuese, një pjesë e të cilave do të trajtohen dhe miratohen së shpejti në KPK.

Ndër të tjera, në mbledhjen e sotme është diskutuar edhe për Agjendën e Reformave në kuadër të Planit të BE-së për rritje ekonomike, Këshilli Prokurorial, konfirmoi se ka dhënë kontribut, duke punuar në bashkëpunim me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë për realizimin e këtij plani dhe është i gatshëm e i përkushtuar për të realizuar obligimet që merr përsipër për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të vendit.

Gjithashtu, në këtë takim, znj. Grantolli, nënvizoi se Këshilli Prokurorial i Kosovës mbetet i përkushtuar për përmbushjen e obligimeve të veta, në mënyrë që të realizohen reformat e nevojshme sipas kompetencave kushtetuese dhe ligjore dhe se KPK-ja është e përkushtuar edhe ndaj perspektivës evropiane dhe procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.



Miratohet Raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2024

Prishtinë, 2 maj 2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe udhëheqëset e njësisve organizative për buxhet dhe financa.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte shqyrtimi i Raporti Financiar për tremujorin e parë të vitit 2024, me ç'rast u trajtuan shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Më pas, ky Raport financiar për tremujorin e parë të vitit 2024 është miratuar nga anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, pa asnjë ndryshim.





Këshilli Prokurorial diskuton me institucionet vendore për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës (CTP)

Prishtinë, 3 maj 2024

Nën organizimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, sot është mbajtur një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar për zotimet e institucioneve të Republikës së Kosovës për përbushjen e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Evropës, në të cilin mori pjesë Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli.

Me këtë rast, gjatë fjalës së saj të rastit, znj. Grantolli, ka theksuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përbushur të gjitha rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe është i gatshëm që të kontribuojë në çfarëdo forme që kërkohet dhe të ndërveprojë me të gjitha institucionet relevante, kurse sipas pjesëmarrësve të tjerë në këtë tryezë, nënvizuan se zbatimi i këtyre rekomandimeve është arritje në rrugën e integritimit evropian dhe shënon përparimin e respektimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë.



Rrjedhimisht, Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës (CPT) ka dhënë 100 rekomandime dhe ka parashtruar 14 kërkesa për informata nga autoritetet kosovare, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë.

Rritja e efikasitetit në trajtimin e lëndëve, përfshirë rastet e dhunës ndaj grave, temë diskutimi e Kryesuesit Hajdaraj me kryeprokurorët e prokurorive në Gjakovë dhe Prizren

Prishtinë, 3 maj 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, vazhdoi aktivitetet e parapara në kuadër të iniciativës për t'i vizituar prokuroritë e vendit, me ç'rast sot vizitoi Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, ku është pritur nga kryeprokurorët i këtyre prokurorie, z.Enis Gashi dhe z.Admir Shala, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre.

Në të dyja takimet e zhvilluara në Gjakovë dhe në Prizren, kryeprokurorët e këtyre prokurorive themelore, njoftuan Kryesuesin Hajdaraj për aktivitetet dhe proceset e zhvilluara të punës në tremujorin e parë të vitit 2024 dhe adresuan sfidat dhe vështirësitë gjatë hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në territorin që kanë në kompetenca të tyre.

Kryesuesi i KPK-së falënderoi kryeprokurorët e prokurorive themelore në Gjakovë dhe Prizren, me ç'rast theksoi se vizitat e tij në prokuroritë e vendit kanë për qëllim njohjen nga afër të proceseve aktuale të punës dhe diskutimin e nevojave për zbatimin e mandateve të tyre kushtetuese dhe ligjore, si dhe ka nënvizuar me fokus të veçantë angazhimin për vazhdimin e trajtimit me prioritet të rasteve të dhunës në familje, sidomos të dhunës ndaj grave.

Z.Hajdaraj, z.Gashi dhe z.Shala u pajtuan për koordinimin e plotë të aktiviteteve të përbashkëta për zbatimin e planeve të punës së këtyre prokurorive për vitin 2024, duke potencuar edhe për angazhimin e Këshillit për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, të cilat do të ndihmonin avancimin e sundimit të ligjit.



Mbahet Takimi i 247-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 7 maj 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 247të me radhë, në të cilin diskutoi dhe miratoi pikat sipas rendit të ditës. Të gjitha vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

- Caktoi pagën e anëtarëve joprokurorë të Këshillit Prokurorial, pagë kjo, që do të jetë e barasvlershme me pagën e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda në prokuroritë e vendit.
- Miratoi Raportin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës për kuadrin deficitar, së bashku me rekomandimin e anëtarëve të KPK-së.
- Miratoi Rregulloren për Mandatin, Strukturën, Funksonimin dhe Organizimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, e cila do të hyjë në fuqi nga dita e sotme.



- Miratoi Planin e Integritetit në sistemin prokurorial.
- Miratoi Raportin e Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023, së bashku me dy rekomandime të këtij komisioni.
- Miratoi Raportin përmbledhës të Komisionit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve për vlerësimin e prokurorëve nga eprorët për vitin 2023, së bashku me rekomandimet e anëtarëve të KPKsë.

- Refuzoi tri (3) kundërshtimet e paraqitura nga ana e kandidatëve ndaj Raportit të procesit të avancimit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe avancoi nëntë (9) prokurorë në Prokurorinë Speciale, si në vijim: z.Naim Gashi, znj.Arbëresha Raça-Shala, znj.Shenaj Berisha, z.Shahadin Destani, z.Halim Borovci, z.Kastriot Memaj, z.Fatos Ajvazi, z.Bekim Kodraliu dhe znj.Ajshe Ferati, të cilët do të fillojnë punën nga data 1 qershor 2024.
- Caktoi anëtarët e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, si në vijim: z.Besim Kelmendi, znj.Jehona Grantolli dhe z.Arian Gashi.
- Aprovoi shpalljen e Konkursit për avancim e një (1) prokurori në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe për avancimin e një (1) prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Gjilan.
- Emëroi prokuroren në Prokurorinë e Apelit, znj.Ikramije Bojaxhiu, në detyrën e anëtares së Këshillit Drejtues në Akademinë e Drejtësisë, me mandat katërvjeçar.
- Refuzoi kundërshtimin e parashtruar dhe miratoi Raportin përfundimtar për vlerësimin e parregullt të performancës së një (1) prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, me ç'rast mori vendim që propozimin për shkarkimin e tij ta dërgojë te Presidentja e vendit.
- Njoftoi për zbatimin e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit.
- Caktoi prokurorin në Prokurorinë Speciale, z.Illir Morina, në Grupin Punues për hartimin dhe finalizimin e Projektregullores për Procedurat për Ndërprerjen e Kërkimit të Personave të Zhdukur.
- Autorizoi Kryesuesin e KPK-së, z.Ardian Hajdaraj, për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Kosovë, i cili do të mundësojë krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore multidisiplinare të veprave komplekse në kompetencë të PSRK-së.
- Autorizoi Sekretariatit të KPK-së për sigurimin e parcelës për ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
- Trajtoi dorëheqjen e anëtarit të ri të KPK-së, z.Visar Krasniqi, nga pozita e Koordinatorit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.



Organizohet aksion vullnetar i dhurimit të gjakut në Këshillin Prokurorial

Prishtinë, 8 maj 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ), organizoi aksionin e dhurimit vullnetar të gjakut në ambientet e këtij institucioni të sistemit prokurorial.

Me rastin e dhurimit të sotëm të gjakut, u tha se inkurajohen të gjithë punonjësit e sistemit prokurorial për dhurimin e gjakut, sepse dhurimi i gjakut është një akt i madh humanitar për shëndetin, jetën dhe shpëtimin e njerëzve në nevojë.

Rrjedhimisht, sot, kësaj nisme të KPK-së iu përgjigjen pozitivisht një numër i konsiderueshëm i punonjësve, si dhe njëkohësisht ky aksion është zhvilluar edhe në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Aksionet e dhurimit të gjakut, që organizon KPK-ja, së bashku me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, janë shndërruar në një traditë ndër vite, ngaqë çdo gjashtë muaj organizohet një nismë e tillë humanitare.



Kryesuesi Hajdaraj mbajti një takim online me përfaqësuesit norvegjezë të administratës së gjykatave norvegjeze

Prishtinë, 8 maj 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, së bashku me Drejtorin e Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi dhe Udhëheqësin e Departamentit të Teknologjisë Informative në SKPK, mbajti një takim online me Këshilltaren e Lartë Rajonale për Reformën Gjyqësore në Administratën e Gjykatave Norvegjeze, znj.Amra Jasevic dhe Zyrtarin e Lartë në Departamentin e Çështjeve Ligjore në Administratën e Gjykatës Norvegjeze, z.Audun Hognes Berg.



Fillimisht, Kryesuesi Ardian Hajdaraj, njoftoi përfaqësuesit norvegjezë për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 që ndërlidhen me zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe për sfidat që janë paraqitur gjatë zbatimit të tij. “SMIL-i është duke u zbatuar në të gjitha prokuroritë themelore, me ç’rast të gjitha lëndët regjistrohen në SMIL, përfshirë edhe shkëmbimin elektronik me Policinë dhe gjykatat”, tha me këtë rast z.Hajdaraj.

Gjatë diskutimeve të zhvilluara, gjithashtu, Kryesuesi Hajdaraj, paraqiti edhe propozimet e reja për projektin e ri të SMIL-it, të cilat përfshijnë digjitalizimin e plotë të punës në prokuroritë e vendit, ngaqë projekti aktual përfundon më 31 maj 2025.

Kryesuesi Hajdaraj dhe përfaqësuesit norvegjezë u shprehën të gatshëm për të vazhduar bashkëpunimin e mëtejshëm, me qëllim të arritjes së objektivave dhe planifikimeve që ndërlidhen me

Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 13 maj 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive të KPK-së, i udhëhequr z.Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e radhës, sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij komisioni, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, z.Mats Persson, Koordinatori i Komisioneve të Përherëshme të KPK-së dhe zyrtarët e Departamentit të Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KPK-së dhe të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

Me këtë rast është bërë prezantimi i Raportit analitik për numrin e nevojshëm të prokurorëve në prokuroritë themelore, i cili përmban nevojat për prokurorë në secilin departament të prokurorive themelore sipas kriterëve të CEPEJ-it dhe i njëjti është aprovuar.

Po ashtu, një grup punues, i caktuar më parë nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive prezantoi format, përfshirë thirrjen dhe fletëkthesën dhe dokumente të tjera pune, të cilat janë aprovuar dhe do t'u shpërndahen prokurorive që t'i përdoren në procesin e punës.

Në takimin e sotëm u prezantuan edhe rekomandimet për përdorimin e statistikave për punën e prokurorive, ku sugjerohet që nga tremujori i dytë i vitit 2024 të fillohet me pilotprojektin e gjenerimit të statistikave përmes SMIL-it në pesë prokurori themelore për regjistrat me kryerës të panjohur (PPP) dhe lëndë të ndryshme (PPN).

Anëtarët e Komisionit formuan grupin punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP).



Zëvendëskryesuesja e KPK-së, Jehona Grantolli, merr pjesë në takimin Komitetit Drejtues për Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026

Prishtinë, 13 maj 2024

Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jehona Grantolli, së bashku me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor, Alber Zogaj dhe Ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu ka marrë sot pjesë në takimin e Komitetit Drejtues për Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026, ku është aprovuar raporti mbi zbatimin e kësaj Strategjie nga akterët e përfshirë në avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Zëvendëskryesuesja Grantolli, në fjalën e saj ka thënë se është gjithmonë nderë që të takohemi në këtë nivel përmes këtij mekanizmi kaq të rëndësishëm për sektorin e drejtësisë ku në çdo takim të këtij formati kemi pasur mundësinë që të diskutojmë sukseset që kanë arritur institucionet tona, aktivitetet që kemi përbushur dhe t'u gjejmë zgjidhje sfidave me të cilat jemi ballafaquar gjatë periudhës përkatëse që mbulon Strategjia për sundimin e ligjit dhe plani i saj I veprimit.

“Edhe këtë periudhë raportimi që ka përfshirë vitin 2023, është vërejtur një angazhim i shkëlqyeshëm nga të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e kësaj strategjie. Kjo dëshmohej nga raporti për zbatimin e planit të veprimit që do të prezantohet sot, ku sukseset dhe të arriturat janë të dukshme për të gjitha institucionet”, ka potencuar Grantolli.



Po ashtu, ajo ka thënë se Këshilli Prokurorial i Kosovës, si një ndër akterët kryesor të këtij procesi, ka një sërë aktiviteteve të parapara për këtë tre vjeçar sa përfshin plani I veprimit.

Andaj, e them me mburrje se niveli i zbatueshmërisë për këtë vit nga KPK-ja, ka arritur 57% të aktiviteteve që i kemi të parapara dhe 28% i kemi në proces. Këtë sukses e ndajmë me të gjitha

institucionet e përfshira në këtë strategji për punën dhe bashkëpunimin e arritur”, është shprehur Grantoli.

Po ashtu, Grantoli ka theksuar se jemi angazhuar edhe në drejtim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies. “Kryeprokurorët e prokurorive kanë raportuar në Këshill në baza tre mujore me shkrim dhe fizikisht dhe të gjitha raportet e tyre tre mujore do të publikohen në uebportalin e sistemit prokurorial. Kemi përzgjedhur Kryeprokurorët e Prokurorisë Speciale, PTH Prishtinë dhe Gjakovë. Kemi finalizuar përzgjedhjen e 2 drejtorëve të administratës, atë të Sekretariatit të Këshillit dhe Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë” ka thënë zëvendëskryesuesja Grantoli.



Për fund, Jehona Grantoli, ka theksuar se jemi në proces të finalizimit të akteve nënligjore që dalin nga Ligji për zyrtarët publik me qëllim të sistematizimit të pozitave në sistemin prokurorial, si dhe, kemi edhe shumë procese të rëndësishme që na presin në muajt në vazhdim e për të cilat angazhimi nuk do të mungojë aspak.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 15 maj 2024

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, ka mbajtur sot takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin kanë marrë pjesë anëtarët e tij Komisioni.

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative pas diskutimit të bërë, kanë finalizuar Draft Rregulloret për Procedurat Disiplinore të Stafit Administrativ, Për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial dhe për Planifikimin e Personelit në Sistemin Prokurorial.



Anëtarët e Komisionit pas finalizimit të Draft Rregulloreve të lartcekura, kanë vlerësuar se hyrja në fuqi e këtyre Rregulloreve do të shërbejë për ta bërë sa më efikase dhe funksionale Administratën e Sistemit Prokurorial.

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative mbajnë takim përfaqësuesit e projektit “Zgjedhjet e Qëndrueshme në Drejtësinë Penale – SCJS

Prishtinë, 15 maj 2024

Kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative të Këshillit Prokurorial, Armend Zenelaj, së bashku me anëtarin e këtij komisioni, Ilir Morina, kanë pritur sot në takim përfaqësuesit e projektit “Zgjedhjet e Qëndrueshme në Drejtësinë Penale – SCJS”, Esmond Adair, Laurence Hanvey dhe Mark McDowell.

Gjatë këtij takimi bashkëbiseduesit kanë diskutuar lidhur me avancimin e efikasitetit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë të sistemeve të Drejtësisë Penale në nivel Global, kurse qëllimi i këtij takimi ishte formimi i një grupi punues për hartimin e Draft Rregullores për formimin e ekipit të përbashkët hetimor, për qëllim të hetimit dhe ndjekjes së veprave penale për të cilat është kompetente Prokuroria Speciale.



Qëllimi i formimit të këtij ekipi është hetimi i suksesshëm i veprave penale përmes bashkëpunimit më efikas në mes të Prokurorisë Speciale dhe institucioneve tjera shtetërore dhe ndërkombëtare.



Mbahet Seminar Rajonal në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE)

Vlorë, 16 maj 2024

Në Seminarin Rajonal, të mbajtur në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE) në Vlorë, morën pjesë përfaqësues të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z.Ardian Hajdaraj, z.Besim Kelmendi, z.Jetish Maloku, znj.Mimoza Shala, z.Bedri Gashi, si dhe përfaqësues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe anëtarë të CCPE-së.

Me këtë rast, pjesëmarrësit prezantuan dhe diskutuan praktikat e mira, të zbatuara në vendet e tyre dhe sfidat e përbashkëta, të ndërlidhura me efikasitetin dhe cilësinë e punës së sistemeve të tyre prokuroriale, si dhe marrëdhënieve në relacionet media-prokurori.





Drejtori Istrefi priti në takim përfaqësuesit e Projektit "Ngritja e kapaciteteve policore dhe hetimore kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda" nga Ambasada Britanike në Prishtinë

Prishtinë, 17 maj 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Sami Istrefi, priti në takim udhëheqësin e Projektit "Ngritja e kapaciteteve policore dhe hetimore kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda" nga Ambasada Britanike, z. Lawrence Harvey, koordinatoren e projektit, znj. Kimete Krasniqi, ekspertin ligjor, znj. Albulena Ukimeri, dhe znj. Altina Besimi, zyrtare për zbatimin e politikave të sistemit të drejtësisë në kuadër të Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Me këtë rast, z. Istrefi, fillimisht, njoftoi mysafirët për aktivitetet e fillimvitit, objektivat dhe prioritetet përgjatë vitit 2024 dhe theksoi se në fokusin kryesor të procesit të punës janë transparenca, integriteti, meritokracia dhe llogaridhënia e administratës, në mënyrë që të kontribuohet për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Më tej, ai diskutoi me përfaqësuesit e këtij projekti për përgatitjen e takimit ceremonial për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, që do të përfaqësohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë, i cili synon përmirësimin e hartimit të akteve nënligjore dhe themelimin e ekipeve të përbashkëta hetimore për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase të veprave penale në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK).

Në përfundim të këtij takimi, u nënvizua se bashkëpunimi do të vazhdojë në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta për të përmirësuar cilësinë e proceseve të punës dhe për të forcuar dhe avancuar kapacitetet e stafit profesional dhe administrativ të sistemit të drejtësisë.



350 kandidatë i nënshtrohen testit kualifikues të kandidatëve për pozitat e 24 prokurorëve të rinj të shtetit

Prishtinë, 19 maj 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) organizoi mbajtjen e Testit Kualifikues, në kuadër të procesit të rekrutimit të njëzetekatër (24) prokurorëve të rinj të Republikës së Kosovës, i cili është mbajtur në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Ky test është zhvilluar në prani të vëzhguesve dhe monitoruesve ndërkombëtarë të EULEX-it dhe OSBE-së, me ç'rast paraprakisht sot Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit hartoi pyetjet për kandidatët që fituan të drejtën për të marrë pjesë në këtë testim.



Në këtë test morën pjesë 350 kandidatë, prej tyre 192 meshkuj dhe 158 femra, prej të cilëve tre janë pjesëtarë nga radhët e minoriteve, dy boshnjakë dhe një turk, që kanë aplikuar përmes sistemit online të menaxhimit të dosjeve dhe përmes dorëzimit të kopjeve fizike, me email dhe postë

të rregullt. Në këtë proces të rekrutimit kanë qenë të rezervuara katër pozita për minoritetin serb, por nuk ka pasur asnjë aplikacion.

Me këtë rast, Kryesuesi i Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, Blerim Isufaj, së bashku me anëtarët e tjerë, ka mbikëqyrë rrjedhën e plotë të mbajtjes së Testit Kualifikues

Rrjedhimisht, në kuadër të monitorimit dhe vëzhgimit të këtij procesi ishin edhe prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë të prokurorive të vendit, prokurorë të deleguar nga Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, prokuroritë themelore dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë nga radhët e EULEX-it dhe OSBE-së.



Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit është duke vazhduar punën në vlerësimin e të gjitha testeve dhe pas përfundimit të vlerësimit të tyre sipas rregullores do të publikohet lista e kandidatëve të cilët kanë kaluar testin dhe lista e kandidatëve që nuk kanë kaluar testin.

Në vijim do të organizohen edhe fazat e tjera të testimit sipas standardeve më të avancuara, të cilat përbëhen nga testi me shkrim dhe intervistimi i kandidatëve.





Kryesuesi Ardian Hajdaraj pret në takim Drejtorin Enver Fejzullahu

Prishtinë, 23 maj 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hadaraj dhe Zëvendëskryesuesja e KPK-së, Jehona Grantolli, kanë pritur në takim Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, për të diskutuar për bashkëpunimin në mes të dy institucioneve, të cilët i udhëheqin këta.



Gjatë këtij takimi, dy bashkëbiseduesit kanë diskutuar për koordinimin e aktiviteteve rreth trajnimeve në fusha të veçanta në bazë të nevojave të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të prokurorive në vend.

Kryesuesi Hajdaraj, theksoi se Këshilli Prokurorial mbetet i përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë, lidhur me organizimin e trajnimeve të nevojshme për sistemin prokurorial, duke potencuar se ky bashkëpunim është për të siguruar që prokurorët dhe administrata e sistemit prokurorial të ketë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer detyrat e tyre me sukses.

Ndërkaq, Fejzullahu, i ka premtuar Kryesuesit Hajdaraj, mbështetjen e Akademisë së Drejtësisë, sipas nevojave të sistemit prokurorial, me qëllim që ky sistem të jetë sa më efikas dhe transparent





Këshilli Prokurorial, Ambasada Britanike dhe Policia e Kosovës nënshkruajnë Memorandum të Bashkëpunimit

Prishtinë, 23 maj 2024

Memorandumi i Bashkëpunimit është nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, Ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, z.Jonathan Hargreaves dhe Drejtori i Policisë së Kosovës, z.Gazmend Hoxha, të cilët mbajtën fjalë rasti.

Në ceremoninë e sotme mbajtën fjalë rasti edhe U.D. Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, z.Besim Kelmendi dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, z.Blerim Isufaj.

Përmes kësaj marrëveshjeje do të luftohet shpëlarja e parave, korrupsioni dhe format e tjera të rënda të krimit, si dhe do të hartohen aktet nënligjore me ekipe të përbashkëta hetimore multidisiplinare për të siguruar hetime më efikase të veprave penale komplekse të cilat janë në kompetencën e Prokurorisë Speciale dhe do të fuqizohen kapacitetet e Policisë së Kosovës në fushën e inteligjencës, duke punuar që Kosova të jetë një vend i sigurt për gjithë qytetarët.



Qendra për Inovacione dhe Zhvillim (CFID) në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës organizojnë punëtori për forcimin e transparencës në sistemin e drejtësisë në Kosovë

Durrës, 23 maj 2024

Qendra për Inovacione dhe Zhvillim (CFID) në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës kanë organizuar një punëtori në kuadër të Projektit “Forcimi i transparencës në sistemin e drejtësisë në Kosovë.”

Në këtë punëtori dyditore morën pjesë zyrtarët për komunikim publik dhe zyrtarët e sektorëve të administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në prokuroritë themelore, si dhe zyrtarët për komunikim publik në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në gjykatat e vendit.

Me këtë rast janë diskutuar praktikatat e mira të komunikimit me median dhe publikun në epokën digjitale, komunikimin ndërmjet rrjeteve sociale dhe platformave digjitale, menaxhimin e komunikimit ndërinstitucional dhe me publikun në situata krizash.





Miratohen raportet tremujore të kryeprokurorëve dhe Strategjia e Komunikimit të Sistemit Prokurorial 2024-2026

Prishtinë, 28 maj 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti takimin e 248-të me radhë.

Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

- Miratoi Strategjinë për Komunikim në Sistemin Prokurorial të Kosovës (2024-2026) me një rekomandim;
- Miratoi raportet e kryeprokurorëve të prokurorive të vendit për periudhën janar-mars 2024;
- Transferoi në mënyrë të përhershme prokuroren Ardiana Veseli nga Departamenti i Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Pejë në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Njoftoi anëtarët e KPK-së për rrjedhën e procesit për avancim në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë;
- Aprovoi shpalljen e brendshme për avancimin e prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe
- Mbajti seancë dëgjimore lidhur me rastin disiplinor ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren, ndërsa vendimi do të bëhet publik sipas ligjeve në fuqi.





Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive me Grupin punues me Grupin punues për përgatitjen e udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP)

Prishtinë, 29 maj 2024

Në udhëheqjen e Kryesuesit të Komisionit, z.Jetish Maloku dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit punues për përgatitjen e udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP), disa prej të cilëve përmes platformës zoom, si dhe stafit përgjegjës të Sekretariatit të KPK-së dhe Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHP).

Diskutohet për detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP, përgatitjen e Raportit analitik për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP) dhe planin kohor të realizimit të aktiviteteve të këtij grupi të punës, kurse në takimin e ardhshëm do të ftohen përfaqësuesit ndërkombëtarë, me qëllim të diskutimit të praktikave dhe standardeve më të mira të BE-së në fushën e trajtimit të këtyre rasteve.



Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj dhe Shefi i EULEX-it, z. Giovanni Pietro Barbano diskutojnë për procesin e bashkëpunimit të ndërsjellë

Prishtinë, 29 maj 2024

Aktivitetet, të arriturat, proceset e tashme dhe sfidat e KPK-së, veçanërisht vështirësitë e krijuara pas dorëheqjeve të prokurorëve dhe stafit administrativ nga radhët e komunitetit serb në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ishin në fokus të takimit të sotëm ndërmjet Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj dhe shefit të EULEX-it, z. Giovanni Pietro Barbano, në të cilin mori pjesë Zëvendëskryesja e KPK-së, znj.Jehona Grantolli dhe përfaqësues të EULEX-it.



Z.Hajdaraj dhe z.Barbano vlerësuan lart rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e monitorimit dhe rritjen e bashkëpunimit KPK-EULEX për të mbajtur takime më të shpeshta, të cilat do të jenë në funksion të realizimit të objektivave të përbashkëta që ndikojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.



Avancimi i bashkëpunimit dypalësh, temë diskutimi mes Kryesuesit Hajdaraj dhe Ambasadorit të Republikës së Turqisë në Kosovë, z.Sabri Tunç Angili

Prishtinë, 30 maj 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj dhe Ambasadori i Republikës së Turqisë në Kosovë theksuan sot rëndësinë e veçantë të bashkëpunimit të ndërsjellë, duke shprehur vullnetin për të zhvilluar partneritetin e përbashkët në fushat përkatëse për fuqizimin e rendit dhe sundimit të ligjit në Kosovë.



Z.Hajdaraj dhe z.Tunç Angili u pajtuan që të realizohen iniciativat e përbashkëta dhe të ketë bashkërendim të bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Ambasadës së Turqisë në Kosovë, me theks të veçantë në çështjet e luftimit të krimit ekonomik dhe krimeve të tjera, mundësinë e shkëmbimit të dyanshëm të përvojave që kanë të bëjnë me praktikat e mira gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorëve dhe digjitalizimin e punës në sistemin prokurorial.



Diskutohet për çështjet e barazisë gjinore dhe përfaqësimin gjinor në sistemin prokurorial

Prishtinë, 30 maj 2024

Kryesuesi i KPK-së, z.Ardian Hajdaraj, së bashku me Zëvendëskryesuesen e KPK-së, znj.Jehona Grantolli, ka pritur sot në takim Kryetaren e Forumit të Grave Prokurore të Kosovës, znj.Laura Pula, me ç'rast ka diskutuar për ecurinë e procesit të punës së Forumit të Grave Prokurore të Kosovës, pas ndarjes nga forumi i përbashkët me gjyqtaret dhe për çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe përfaqësimin adekuat gjinor në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial të Kosovës.



Z.Hajdaraj, tha se viteve të fundit ka pasur rezultate të mira në drejtim të arritjes së synimeve për përfshirjen në vendimmarrje të grave prokurore dhe kjo çështje është pasqyruar në një raport për vlerësimin institucional gjinor dhe përfshirjen sociale në sistemin prokurorial të Kosovës, raport ky, i cili është mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Pjesëmarrësit në këtë takim potencuan se do të ketë bashkëpunim të shtuar në mes të Këshillit Prokurorial dhe Forumit të Grave Prokurore të Kosovës, në mënyrë që të realizohen përpjekjet që gratë të kenë rolin dhe pozitën e tyre legjitime në sistemin prokurorial.



Komisioni për Çështje Normative analizon Drafttregulloren për Transferimin dhe Avancimin dhe Drafttregulloren për Vlerësimin e Rezultateve të Punës së Stafit Administrativ

Prishtinë, 31 maj 2024

Gjatë takimit të sotëm, anëtarët e Komisionit analizuan draftin e Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Stafit në Sistemin Prokurorial, me anë të së cilës përcaktohen rregullat dhe procedurat për transferim të përkohshëm, të përhershëm, transferim në rast të riorganizimit dhe për avancimin e stafit administrativ në sistemin prokurorial.

Po ashtu, ky Komision analizoi edhe draftin e Rregullores për Vlerësimin e Rezultateve të Punës së Stafit Administrativ, më anë të së cilës përcaktohen kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë të stafit administrativ në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës, së bashku

me dy formularët për vlerësimin e rezultateve në punë dhe formularin e trajnimit.

